FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.43 24 mars 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ nr.1, datë 24.3.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008".....	1969
Vendim i GJK nr.7, datë 11.3.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.949, datë 4.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.164, datë 16.2.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si të papajtueshëm me Kushtetutën ……	1969
Vendim i GJK nr.8, datë 13.3.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.542, datë 2.5.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën ……	1972
Vendim i BSH nr.21, datë 12.3.2008	Për tërheqjen nga qarkullimi të disa kartëmonedhave me kurs ligjor ……	1977
Vendim i BSH nr.22, datë 12.3.2008	Për revokimin e licencës së Bankës Italo Shqiptare sh.a……..	1978

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 24.3.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9836, DATË 26.11.2007 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2008"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në fjalinë e fundit të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", fjala "Kuvendi" zëvendësohet me "Këshilli i Ministrave".

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.7, datë 11.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese,
Gjergj Sauli	Anëtar	i "	"
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kristofor Peçi	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"

me sekretare Brunilda Bara, në datë 22.1.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.59/13 Akti, që i përket:

KËRKUES: AQIF KUKA, HAZIS KUKA, përfaqësuar nga av.Gjet Kola, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

IBRAHIM LIKA, përfaqësuar nga avokate Mirela Roshi, me prokurë.

KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, QARKU DIBËR, në mungesë.

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONËS PUBLIKE (Ish AKP), përfaqësuar nga z.Sotiraq Veizi, me autorizim.

DREJTORIA E BUJQËSISË MAT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.949, datë 4.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.164, datë 16.2.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 germa "f" e 134 germa "g" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit Hazis Kuka e Aqif Kuka kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të mësipërme:

gjykatat nuk kanë respektuar parimet kushtetuese për barazinë e palëve dhe paanësinë në gjykim, sepse i kanë bazuar vendimet e tyre mbi një dokument të falsifikuar;

gjykata e apelit, ka pranuar si shkak të prishjes së vendimit të gjykatës së rrethit moskomunikimin palëve të shtesës së objektit të padisë, pa u ngritur ky pretendim nga palët e dëmtuara;

Gjykata e Lartë ka pasur në përbërje të saj një gjyqtar, i cili ka marrë pjesë dhe në trupin gjykues të gjykatës së apelit;

gjykata e apelit, duke vendosur rrëzimin e padisë, u ka mohuar të drejtën për të ngritur përsëri padi në gjykatë, me të njëjtin objekt.

Subjektet e interesuara Ibrahim Lika dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike kanë parashtruar:

parimi i paanësisë së gjykatës në proces ka të bëjë me dhënien palëve të mundësive të barabarta për të paraqitur çështjen dhe organizuar mbrojtjen, ndërsa mënyra e vlerësimit të provave nuk mund të përbëjë shkelje të këtij parimi;

gjykata e apelit ka gjykuar mbi faktin se kërkuesit nuk legjitimohen të vënë në lëvizje gjykatën përderisa, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", duhet të shprehen fillimisht organet e kthimit e të kompensimit të pronave;

gjykata e apelit nuk u ka mohuar kërkuesve të drejtën e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes z.Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesve që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar Ibrahim Lika, që u shpreh për rrëzimin e kërkesës, të subjektit të interesuar Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, e cila e la në çmim të Gjykatës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr.258, datë 10.5.2004, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr.1, datë 18.1.1996 të KKK Pronave dega Mat me arsyetimin, se mbështetet në një akt të falsifikuar dhe, ka kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Ajo ka konstatuar si të pavlefshme dhe kontratën e privatizimit nr.60, datë 31.8.2001 të lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Dibër dhe subjektit të interesuar Ibrahim Lika, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Gjykata e rrethit ka rrëzuar kërkesë padinë e kërkuesve përsa i përket detyrimit për t'u njohur pronarë nga subjekti i interesuar Ibrahim Lika.

Mbi ankimin e këtij të fundit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.949, datë 4.10.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.258, datë 10.5.2004 të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin tërësisht të kërkesë padisë së kërkuesve. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.164, datë 16.2.2007 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve Hazis Kuka e Aqif Kuka.

Gjykata e apelit ka pranuar se kërkuesit duhet t'i drejtoheshin Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të kërkuar kthimin e sipërfaqes së tokës që ata pretendojnë, përpara se të kërkonin në gjykatë anulimin e vendimit me të cilin Komisioni i ka kthyer sipërfaqen subjektit të interesuar Ibrahim Lika. Këtë qëndrim gjykatat e bazojnë në nenin 59/1 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit, gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë dhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksion gjyqësor apo administrativ. Por, Gjykata Kushtetuese vëren se gjykata e apelit, ndërsa ka pranuar që çështja me paditës kërkuesit dhe objekt anulimin e vendimit të Komisionit dhe kthimin në gjendjen e mëparshme nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, por në atë administrativ, u ka mbyllur kërkuesve rrugën për të realizuar deri në fund të drejtat e pretenduara. Ajo ka vendosur rrëzimin e padisë së tyre. Ky qëndrim, vjen në kundërshtim me nenin 468 të Kodit të Procedurës Civile që përcakton, se kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kur padia nuk mund të ngrihet, gjykata, krahas prishjes së vendimit vendos dhe pushimin e çështjes. Jo vetëm kaq, por gjykata e apelit u ka hequr kërkuesve mundësinë, që në rast refuzimi të kërkesës së tyre nga Komisioni, t'i drejtohen përsëri gjykatës për zgjidhjen në themel të çështjes.

Mohimi i të drejtës së aksesit, d.m.th. i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane, si dhe i trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca e kësaj gjykate. Gjykata Kushtetuese konstaton, se në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë pa e zgjidhur çështjen në themel, pra pa u dhënë përgjigje kërkesave për pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe lidhur me këtë dhe kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes së objekteve mbi këtë sipërfaqe dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Rrëzimi i padisë nga gjykata, pa dhënë një vendim përfundimtar, megjithëse mund të arsyetohet me mungesën e juridiksionit dhe të legjitimitetit, mund t'u heqë kërkuesve mundësinë të vënë përsëri në lëvizje gjykatën dhe të marrin përgjigje përfundimtare për problemet e themelit të çështjes.

Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu se gjykatat kanë cenuar parimin e barazisë së palëve në gjykim dhe atë të paanësisë, pasi kanë bazuar vendimin në një dokument të falsifikuar.

E drejta për një gjykim të rregullt e të drejtë përfshin parimin e barazisë së mjeteve, që do të thotë, që secila palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit.

Në çështjen në shqyrtim nuk rezulton që gjykata e apelit të këtë refuzuar marrjen e provave, mungesa e të cilave e ka bërë gjykatën të japë një vendim jo të drejtë. Në këtë proces janë marrë dhe administruar provat nga të dy gjykatat, nga ajo e rrethit dhe nga ajo e apelit, por kjo e fundit, pa u ndalur në analizën e vërtetimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili ka rezultuar i falsifikuar, ka përcaktuar si shkak kryesor të prishjes së vendimit të gjykatës së rrethit mosrespektimin e procedurave ligjore, siç është dhe mosshqyrtimi paraprak i pretendimeve të kërkuesve si ish pronarë nga KKK Pronave. Problemi nëse gjykata e apelit duhet të ndalej dhe të analizonte vërtetimin e falsifikuar, ka të bëjë me vlerësimin që ajo i ka bërë rëndësisë së kësaj prove për zgjidhjen juridike të çështjes, por ky fakt në vetvete, nga pikëpamja e shqyrtimit kushtetues, nuk mund të çojë në konkluzionin se u ka mohuar kërkuesve mundësitë e barabarta me palën tjetër për të organizuar mbrojtjen e tyre.

Në Gjykatën Kushtetuese kërkuesit nuk provuan gjithashtu se gjykata e apelit ka cenuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar në seancë nga gjyqtarë të paanshëm. Paanshmëria paraqitet në dy aspekte: njëri është testi objektiv që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, ndërsa tjetri, është testi subjektiv që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Paanësia e gjykatës në një proces pranohet se është një garanci kushtetuese për çdo individ, por nga ana tjetër, pranohet gjithashtu, se gjykimi, konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët në rrjedhën e procesit të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën. Pretendimi i kërkuesve për paanësinë e gjykatës së apelit ngaqë ajo ka anashkaluar vërtetimin e falsifikuar, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se gjykata ka qenë e anshme. Për më tepër, siç e përmendëm më lart, shkaku kryesor i rrëzimit të padisë për anulimin e vendimit të Komisionit nga gjykata e apelit nuk kanë qenë problemet e themelit, por mungesa e legjitimimit ngaqë kërkuesit nuk i janë drejtuar më parë organit administrativ.

Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu, se Gjykata e Lartë, ka cenuar parimin e paanësisë, përderisa një nga gjyqtarët që ka marrë pjesë si anëtare e trupit gjykues në atë gjykatë, ka marrë pjesë dhe në gjykimin në apel.

Në dosjen gjyqësore Gjykata Kushtetuese konstaton, se gjyqtarja e pretenduar ka marrë pjesë në përbërjen e trupit gjykues në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Lartë, ku është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuesve për mungesë të shkaqeve ligjore të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Në gjykatën e apelit ajo ka marrë pjesë në gjykimin e datës 03.10.2002, kur është pranuar ankesa e kërkuesve kundër vendimit të gjykatës së rrethit dhe, për mangësi procedurale, është prishur ky vendim e çështja është dërguar për rigjykim në atë gjykatë. Në gjykimin nga gjykata e apelit, kjo gjyqtare nuk ka qenë në përbërje të trupit gjykues.

Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se nuk është cenuar standardi kushtetues i paanësisë së gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.949, datë 4.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.164, datë 16.2.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Vladimir Kristo.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Berberi.

VENDIM
Nr.8, datë 13.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese,	
Gjergji Sauli	Anëtar	i "	"
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kristofor Peçi	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"

me sekretare Brunilda Bara, në datë 19.11.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.51/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: SINDIKATA E PAVARUR E USHQIMIT, me qendër në Tiranë, përfaqësuar nga avokat Rustem Gjata, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

SHOQËRIA "TITAN KONSTRUKSION" SHPK, me qendër në Sarandë, përfaqësuar nga avokatët Dashamir Kore dhe Maksim Haxhia, me prokurë.

BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokatët Vitore Tusha dhe Baftjar Rusi, me autorizim.

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZRPP) SARANDË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.542, datë 2.5.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit nr.542, datë 2.5.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka parashtruar këto shkaqe:

legjitimimi i paditësit "Titan Konstruksion" sh.p.k. është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC);

është bërë tejkalim i objektit të padisë gjatë shqyrtimit gjyqësor; objekti i padisë përmban

detyrime të natyrës administrative, ndërsa shtesa e objektit të padisë përmban pretendimin për pavlefshmërinë e veprimit juridik;

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit; mosmarrëveshja, nisur nga objekti i padisë, konsiderohet e natyrës administrative;

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në gjykim ka bërë vlerësim provash, çka bie në kundërshtim me nenin 472 të KPC; Kolegji nuk kishte të drejtë të bënte vetëvlerësim provash, por ishte i detyruar të vendoste prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim .

Subjektet e interesuara u shprehen për mospranimin e kërkesës, sepse shkaqet e pretenduara nga kërkuesi nuk janë të tilla që e bëjnë procesin të parregullt; ato janë pretendime që lidhen me interpretimin e ligjit dhe janë objekt i shqyrtimit të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, z.Sokol Berberi, përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Subjekti i interesuar, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH), më datë 15.5.1997 ka lidhur një kontratë dhurimi me kërkuesin, Sindikatën e Pavarur të Ushqimit (SPU), sipas së cilës i dhuron pronën e përbërë nga godina e Kampit të Pushimit të Sarandës, së bashku me anekset dhe truallin 30.000 m^2. Kjo pronë është regjistruar në favor të kërkuesit më datë 29.5.2000.

Subjekti i interesuar, Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k. ka lidhur me BSPSH-në më datë 18.5.2000 një kontratë qiraje me afat 20-vjeçar. Kjo Shoqëri ka paraqitur një kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Sarandës, duke pretenduar se kontrata e dhurimit, e lidhur midis subjektit të interesuar, BSPSH dhe kërkuesit, SPU, është veprim juridik i pavlefshëm dhe për pasojë duhet të anulohet regjistrimi i kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) të Sarandës dhe të bëhet regjistrimi i kontratës së qirasë të lidhur nga kjo Shoqëri me BSPSH-në.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.386, datë 26.6.2000, i ka konsideruar pretendimet e paditësit të provuara dhe ka pranuar kërkesë padinë. Gjykata e Apelit të Gjirokastrës, me vendimin nr.81, datë 9.3.2005 ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes me arsyetimin, se është shkelur neni 185 i KPC (shtesa e objektit të kërkesë padisë) dhe se, lidhur me themelin e çështjes, paditësi nuk legjitimohet në ngritjen e padisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.542, datë 2.5.2007 ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

II

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i përmendur më sipër, është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, çka vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta), si dhe me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe ka kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi.

Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) përqendrohet në ato pretendime që kanë të bëjnë me parimet themelore të procesit gjyqësor civil.

1. Pretendimi për legjitimimin jo sipas ligjit të subjektit të interesuar.

Kërkuesi parashtroi se legjitimimi i subjektit të interesuar, shoqërisë "Titan Konstruksion" sh.p.k. është bërë në kundërshtim me dispozitat e KPC dhe se gjykata nuk ka bërë dallim ndërmjet kontratës së dhurimit dhe asaj të qirasë; qiramarrësi nuk legjitimohet në kundërshtimin e një veprimi juridik për kalimin e pronësisë së kryer ndërmjet qiradhënësit dhe personit të tretë; subjekti i interesuar, Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k., nuk ka asnjë marrëdhënie juridike me kërkuesin me cilësinë e palës së paditur, as me karakter kontraktor, as jashtëkontraktor.

Subjekti i interesuar, Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k., kundërshtoi pretendimin e kërkuesit me argumentin se pretendimi mbështetet në një shkak jo të karakterit kushtetues, të kërkuar

nga neni 131/f i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së. Ai gjithashtu parashtroi, se në momentin e ngritjes së padisë, kjo Shoqëri ka qenë pronare në masën 60 për qind të Kampit të Pushimit të Sarandës, i cili ka qenë objekt disponimi në kontratën e dhurimit; në këtë kontratë dhurimi është disponuar edhe pjesa e pronësisë së paditësit; kjo Shoqëri, si pronare në masën 60 për qind të objektit, ka një interes të ligjshëm të kërkojë pavlefshmërinë e kësaj kontrate.

Subjekti i interesuar BSPSH parashtroi, se Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k. ka interes të ligjshëm, i cili buron nga neni 197 i Kodi Civil (KC) për regjistrimin e kontratës së qirasë; kontrata e dhurimit e ka bërë të pamundur regjistrimin e kontratës së qirasë në favor të kësaj Shoqërie, ndaj dhe ajo ka një interes të ligjshëm në kërkimin e konstatimit të pavlefshmërisë së kësaj kontrate si një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm; pavlefshmëria absolute mund të pretendohet nga kushdo që ka interes.

Gjykata, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuesit, çmon të nevojshme të trajtojë disa vlerësime të përgjithshme lidhur me legjitimimin për të ngritur padi.

Praktika e Gjykatës, çështjen e legjitimimit të palëve në një proces civil, e ka vlerësuar në këndvështrimin e standardit të aksesit në gjykatë si një element të procesit të rregullt. Moslegjitimimi i një subjekti, që duhet të legjitimohet në bazë të ligjit, përbën shkak për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Gjykata, lidhur me legjitimimin e palëve në proces civil dhe në përputhje me nenin 42/2 të Kushtetutës është shprehur, se Kodi i Procedurës Civile, në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në atë të posaçme, zbërthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë çka garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 KPC-ja e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e në ligje ose jo, kurse neni 32, shkronja "a" parashikon, se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (shih Vendimin nr.5, datë 20.3.2006 të Gjykatës).

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) shprehet, se neni 6/1 i KEDNJ-së mishëron të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate, në të cilën përfshihet e drejta për të filluar një procedurë përpara një gjykate për një çështje civile (Shih çështjen Goedler kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.2.1975; dhe Devlin kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 20.10.2001 të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut).

Gjykata çmon, se vetëm fakti i legjitimimit të një subjekti për të ngritur padi, që nuk duhet të legjitimohet sipas ligjit, nuk cenon në çdo rrethanë të drejtën e palës tjetër për proces të rregullt ligjor. Në këtë rast Gjykata vlerëson nëse janë respektuar të drejtat e palës kundërshtare për një proces gjyqësor kontradiktor.

Gjykata, bazuar në këto vlerësime të përgjithshme, vijon me vlerësimin e pretendimit të kërkuesit bazuar në rrethanat e çështjes.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi, se subjekti i interesuar, "Titan Konstruksion" sh.p.k, në fazën e veprimeve përgatitore, ka shtuar objektin e padisë duke kërkuar, që gjykata, të shpallte si të pavlefshme kontratën e dhurimit nr.2591 rep. dhe nr.1040 kol. me datë 15.5.1997. Kjo shtesë është pranuar shprehimisht nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe është njoftuar pala në mungesë. Në përfundim të gjykimit gjykata e rrethit, me vendimin nr.386, datë 26.6.2000 ka pranuar padinë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi. Gjykata e apelit me vendimin nr.81, datë 9.3.2005 ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.542, datë 2.5.2007 ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, pavarësisht nga pretendimi për legjitimim jo të bazuar në ligj të shoqërisë "Titan Konstruksion" sh.p.k., është zhvilluar proces gjyqësor dhe kërkuesit nuk i janë cenuar të drejtat si palë kundërshtare për të ngritur prapësimet, si dhe, për të ushtruar kundërpadinë, mbi bazën e një procesi gjyqësor kontradiktor.

Për këto arsye, Gjykata çmon, se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor, për shkak të legjitimimit jo të drejtë të subjektit të interesuar "Titan Konstruksion" sh.p.k, nuk është i mbështetur.

2. Pretendimi për interpretim të gabuar të ligjit për ndryshimin e objektit dhe shkakut të padisë.

Kërkuesi parashtroi, se objekti i padisë, përmban detyrime të natyrës administrative, ndërsa shtesa e objektit të padisë përmban pretendimin për pavlefshmërinë e veprimit juridik; neni 185 i Kodit të Procedurës Civile ndalon shprehimisht ndryshimin njëkohësisht të dy elementeve të padisë,

objektit dhe shkakut ligjor të saj; respektimi i këtij detyrimi nuk lidhet vetëm me gjykatën por dhe palët ndërgjyqëse.

Subjekti i interesuar, Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k. kundërshtoi parashtrimet e kërkuesit, duke dhënë këto argumente: kërkuesi nuk argumenton se çfarë elementi të procesit të rregullt ligjor është shkelur në rastin konkret; në fazën e kryerjes së veprimeve përgatitore u saktësua padia, e cila përbëhej nga dy kërkime dhe se kërkimi i parë kishte të bënte me shpalljen nga gjykata si të pavlefshme të kontratës së dhurimit, duke përcaktuar edhe shkakun ligjor ku e mbështet këtë kërkim; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë u ka komunikuar palëve plotësimet dhe saktësimet e bëra në fazën e seancës së veprimeve përgatitore; paditësi, gjatë hetimit gjyqësor, nuk e ka ndryshuar edhe shkakun edhe objektin e padisë; e drejta për të bashkuar kërkimet në një padi është një e drejtë që i përket vetëm paditësit.

Subjekti i interesuar, BSPSH, ndër të tjera kundërshtoi pretendimin e kërkuesit me argumentin se nuk kemi të bëjmë me shqyrtimin e një padie të re nga gjykata dhe as me shkelje të nenit 185 të KPC; pavlefshmëria absolute, edhe pa u pretenduar nga palët, mund të konstatohet kryesisht nga gjykata.

Gjykata është shprehur, se është në kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm interpretimi i dispozitave ligjore për shkakun juridik dhe objektin e padive që duhen ngritur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe vlerësimi juridik i rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 15.4.2005; nr.36, datë 19.12.2003). Kjo Gjykatë nuk vlerëson nëse interpretimi i nenit 185 të KPC nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt.

Neni 185 i KPC përcakton se: "Paditësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai, pa ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë.". Nga kërkuesi nuk u paraqitën argumente, për të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak të interpretimit të gabuar të kësaj dispozite procedurale. Nga gjykimi i çështjes nuk rezulton që kërkuesi të jetë vënë në pozitë të pafavorshme në raport me palët e tjera. Ai ka realizuar të drejtën e mbrojtjes në gjyq, duke dhënë shpjegime. Pretendimet e ngritura janë shqyrtuar dhe për to është dhënë përgjigje nga gjykata, duke siguruar të drejtën e dëgjimit dhe duke respektuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

Për sa më sipër, Gjykata nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak të interpretimit të gabuar të nenit 185 të KPC lidhur me ndryshimin njëkohësisht të objektit dhe shkakut të padisë.

3. Pretendimi për mosshterim të rrugës administrative.

Kërkuesi parashtroi, se gjykata e rrethit duhet ta kishte nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, bazuar në nenin 59 të KPC; mosmarrëveshja, nisur nga objekti i padisë, konsiderohet e natyrës administrative bazuar në nenet 324-333 të KPC dhe nenet 1, 52, 53 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

Subjekti i interesuar, Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k. kundërshtoi pretendimin e kërkuesit, duke dhënë këto argumente: objekti kryesor i gjykimit ka qenë pavlefshmëria e kontratës së dhurimit; kjo do të thotë se në bazë të neneve 192-196 të KC, çdo fakt juridik, që ka lidhje me gjendjen juridike të sendeve të paluajtshme, duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; sipas nenit 196 të KC, vendimi i gjykatës, që deklaron të pavlefshëm kontratën e dhurimit, do të shkojë për regjistrim në ZRPP edhe nëse paditësi këtë gjë nuk e kërkon posaçërisht në kërkesë padi; në këto rrethana për në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për çështje juridiksioni.

Subjekti tjetër i interesuar, BSPSH parashtroi ndër të tjera, se ligji nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", në nenin 48 parashikon shprehimisht rastet për të cilat mund të bëhet ankim administrativ te kryeregjistruesi; asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 48 të këtij ligji nuk ka të bëjë me çështjen në gjykim.

Gjykata e vlerëson çështjen e juridiksionit lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 11.5.2006). Sipas kësaj të drejte, çdo individ ka të drejtë

për t'u drejtuar me padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Ajo nuk vlerëson nëse interpretimi i dispozitave procedurale lidhur me juridiksionin administrativ dhe gjyqësor është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor.

Gjykata nuk e ka konsideruar cenim të procesit të rregullt ligjor rastin kur gjykata ka pushuar çështjen me argumentin e mosezaurimit të rrugës administrative, por duke mos i mohuar më pas ankimin në gjykatë (shih vendimin nr.18, datë 17.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese).

Bazuar në këto qëndrime të përgjithshme, Gjykata vlerësoi pretendimin e kërkuesit lidhur me çështjen e juridiksionit.

Nga gjykimi i çështjes nuk rezulton që kërkuesit t'i jetë cenuar e drejta e aksesit në gjykatë. Gjithashtu, nga ana e kërkuesit nuk u dhanë argumente për cenimin e ndonjë elementi tjetër të procesit të rregullt ligjor, i ardhur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të dispozitave lidhur me juridiksionin. Edhe ky pretendim i kërkuesit është shqyrtuar dhe i është dhënë përgjigje nga gjykata, duke siguruar të drejtën e dëgjimit dhe duke respektuar parimin e paanësisë në gjykim.

Gjykata nuk e gjen të mbështetur dhe pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak të mosnxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

4. Pretendimi për vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë.

Kërkuesi parashtroi, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në gjykim ka bërë vlerësim provash lidhur me përqindjen e pronës që ka pasur në pronësi subjekti i interesuar, BSPSH, dhe të pronës së dhuruar; kjo bie në kundërshtim me nenin 472 të KPC; Kolegji Civil nuk kishte të drejtë të bënte vetëvlerësim provash duke përkrahur vlerësimin e njërës gjykatë, por ishte i detyruar të vendoste prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, sipas nenit 485/e të KPC.

Subjekti i interesuar, BSPSH, kundërshtoi argumentet e kërkuesit, duke parashtruar, se Kolegji Civil nuk ka formuar fakte të reja që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, por ka përkrahur vlerësimin e provave të gjykatës së rrethit, për të arsyetuar vendimin.

Gjykata është shprehur, se barazia e armëve dhe marrja e provave në mënyrë të ligjshme, përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 19.7.2005). Marrja dhe vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Megjithatë, kjo Gjykatë ka detyrimin të vlerësojë nëse procesi gjyqësor i zhvilluar, në tërësinë e tij, përmbush kërkesat e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 8.6.2007). Gjykata është shprehur se, sipas nenit 472 të KPC, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por nuk mund të bëjë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta dhe mbi këtë bazë të vendosë rrëzimin e kërkesëpadisë (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 30.4.2007).

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi, Gjykata nuk konstaton cenim të standardeve të lartpërmendura nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes. Ky i fundit është përqendruar në kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së apelit. Përfundimet e veta i ka bazuar në provat e administruara e të vlerësuara në gjykatën e apelit.

Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në gjykim ka bërë vlerësim provash, është i pambështetur.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Vladimir Kristo.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Berberi.

VENDIM
Nr.21, datë 12.3.2008

PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË DISA KARTËMONEDHAVE ME KURS LIGJOR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, gërma "b", të nenit 40, pika 5, të nenit 43, gërmat "c" dhe "d" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të kreut II të udhëzimit "Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi të parasë", miratuar me vendimin nr.27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të kreut II, pika 5 të rregullores "Për funksionimin e Departamentit të Emisionit", të miratuar me vendimin nr.21, datë 28.3.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave me kurs ligjor si më poshtë:

a) Kartëmonedha prerje 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996, imazhi i Luftëtarit Kombëtar.

b) Kartëmonedha prerje 100 lekë, emetim i vitit 1996, imazhi i Fan S.Nolit.

c) Kartëmonedha prerje 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996, imazhi i Ismail Qemalit.

2. Kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi do të kenë kurs ligjor deri në datën 31.12.2008.

3. Kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi do të mblidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim, deri në datën 31.12.2010.

4. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim, deri në datën 31.12.2010, kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe t'i dërgojnë ato pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saja.

5. Ngarkohen Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe të shpallë njoftimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.22, datë 12.3.2008

PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË BANKËS ITALO SHQIPTARE SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të nenit 28, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të revokojë licencën e Bankës Italo - Shqiptare sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË 1000 lekë

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 24.3.2008
Doli nga shtypi më 24.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2008

Çmimi 14 lekë